Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstine Vitina
Municipality Viti

# PLANI I PUNËS SË ZYRËS PËR INFORMIM PUBLIK DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN PUBLIK 2022

Janar 2022

# HYRJE

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve dhe obligimeve të Zyrës për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) dhe më qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe sigurimit të punës sa më transparente të Institucioneve Komunale të Vitisë, kjo zyre ka përgatitur këtë plan të punës që parasheh të siguroj:

## 1. Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal të Vitisë dhe të Komiteteve të tij, janë të hapura për publikun. Ato paralajmërohen me kohë nga ana e sekretarisë së Kuvendit, ndërkaq nga ana e zyrtarëve për informim, në të njëjtën kohë publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës së Vitisë dhe llogarinë e rrjetit social Facebook. Mbledhjet janë të hapura për publikun dhe publiku në vazhdimësi do të informohet për këto mbledhje dhe për të drejtën e pjesëmarrjes si publik. Gjithashtu propozim dokumentet e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Kuvendit Komunal të Vitisë (KK) do të vazhdojnë të publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës së Vitisë kk.rks-gov.net/viti tek rubrikat përkatëse.

## 2. Përgatitja dhe publikimi i informatave nga mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve

Pas përfundimit të mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Vitisë dhe Komiteteve, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun pas dërgimit të dokumenteve nga organet përgjegjëse do të bëjë publikimin e tyre në ueb faqe të Komunës. Po ashtu informatat për këtë do të ju dërgohen edhe mediave.

## 3. Takimet e Kryetarit me Publikun

Me qenë se Kryetari i Komunës, sipas ligjit është i obliguar që të mbajë së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, ku mund të marrë pjesë secili qytetar, shoqëria civile dhe grupet e caktuara të interesit. Në këtë rrafsh ZIMP Zyra e Kryetarit, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme.

Njoftimi duhet të bëhet në ueb faqen zyrtare, në media të shkruara dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës, sikur edhe në rrjetet sociale. Pas mbajtjes së takimeve të kryetarit, publikohet informata për media në mjetet e informimit të cilat janë në dispozicion. Këtu varësisht nga situata pandemike dhe konform rekomandimeve të IKSHPK-së që mund të vijnë si pasojë e virusit Covid-19, takimet e tilla mund të mbahen edhe online pa prani fizike.

## 4. Konsultimet me Publikun

Komuna e Vitisë përpos dy debateve të lartë cekura, do të organizon edhe konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, pronën komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera të përgjithshme, apo me interes të veçantë . Sekretaria e Kuvendit Komunal , përmes zyrtarit për Informim Publik, njofton publikun së paku dy javë para mbajtjes së konsultimeve publike: në ueb faqen zyrtare, mediat e shkruara dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës si dhe në rrjetet sociale. Pas mbajtjes së konsultimeve, publikohet informata për media në ueb faqe.

## 5. Konferencat për media

Kryetari i Komunës së Vitisë, Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe drejtorët e Drejtorive komunale mbajnë konferenca për media sipas nevojës dhe atëherë sa herë që është nevojshme dhe në interes të publikut. Të gjitha informatat nga konferencat publikohen në ueb faqe zyrtare të Komunës, në rrjetin social Facebook, youtube etj.

## 6. E drejta e qasjes në dokumente publike

E drejta për qasje në dokumentet publike do të sigurohet sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe në veçanti edhe sipas Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me shkrim ose në formë elektronike ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi.

## 7. Publikimi i akteve komunale

Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit Komunal të Vitisë, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit, bëhen publike dhe të qasshme për publikun, pas vlerësimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentet tjera publike publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës së Vitisë. Për dërgimin e akteve në formë elektronike pranë Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun është përgjegjëse Sekretaria e Kuvendit, ndërsa përgjegjës për publikim është ZIMP-ja.

## 8. Mirëmbajtja dhe përditësimi i ueb faqes zyrtare dhe përgatitja e materialit të shtypur

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Vitisë mirëmbahet dhe freskohet me informacione dhe dokumente publike sipas Udhëzimit Administrativ dhe ligjeve në fuqi. Përgjegjës për këtë është Zyra për Informim në bashkëpunim të ngushtë me Zyrtarin e IT-së së Komunës së Vitisë. Ndërkaq, sipas mundësive financiare do të bëhet përgatitja dhe shtypja e informatorëve, vjetarëve për një periudhë të caktuar.

## 9. Shfrytëzimi i rrjeteve sociale

Komuna e Vitisë pos uebfaqës zyrtare standarde ka edhe llogarinë e hapur në rrjetin social facebook, e cila do të shfrytëzohet me qëllim të informimit të publikut për çështjet e interesit publik.

## 10.Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik

Zyra për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun, pranon rregullisht dokumentet e prokurimit publik nga zyrtarët përgjegjës të prokurimit dhe i publikon ato me kohë në uebfaqën zyrtare. Përgjegjës për publikim të tyre në ueb faqe zyrtare të komunës është Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, deri sa të mos përcaktohet ndryshe me dokument të shkruar.

## 11. Publikimi i dokumenteve të punësimit

Komuna e Vitisë, përkatësisht Zyra e Personelit, është përgjegjëse për publikim në ueb faqe dhe në media të shkruara e elektronike të konkurseve, njoftimeve për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimeve për anulim të konkurseve, rishpalljen apo vazhdimin e konkurseve, avancimet brenda institucionit si dhe aplikacionet për punësim. Por publikimi do të bëhet nga Zyra për Informim Publik, pas pranimit të dokumenteve nga zyra përkatëse.

Tabela e aktiviteteve të parapara në periudhën një vjeçare:

Vini Re: Këto janë vetëm disa nga aktivitetet që janë mundur të parashihen nga Zyra për Informim, megjithatë mund të këtë edhe shumë aktivitete të tjera të cilët ndërlidhen me drejtoritë dhe sektorë të tjerë dhe që janë në interes të publikut.

| Muaji | Aktivitetet |
|---|---|
| JANAR | ➢ Publikimi i planeve vjetore për vitin 2022 dhe të raporteve vjetore për vitin 2021 të dërguara nga Zyra e Kryetarit, Drejtoritë dhe sektorë përkatës në ueb faqe.<br>➢ Përgatitja e Raportit të punës të ZIMP-së<br>➢ Përgatitja e Raportit për Qasjet në Dokumentet Publike të shqyrtuara gjatë vitit 2021 në MAPL dhe në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.<br>➢ Përgatitja e Planit të punës të ZIMP-së.<br>➢ Plotësimi i të dhënave për Performancë Komunale në fushën e Transparencës Komunale dhe të Përgjegjshmërisë Komunale për sistemin elektronik të PMS-it për vitin paraprak.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i njoftimeve të komunës, përfshirë këtu hartimi i njoftimeve publike në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal për takimin e parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Kuvendit Komunal.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së parë të Kuvendit Komunal për publikun. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim.<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve kulturore sportive në përzgjedhjen e laureatëve të vitit në fushën e kulturës, artit dhe sportit për vitin 2021.<br>➢ Shqyrtimi fillestar i kërkesave për qasje në dokumentet publike. |
| SHKURT | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 17 Shkurtit-Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i njoftimeve të komunës, përfshirë këtu hartimi i njoftimeve publike në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal për takimin e dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Kuvendit Komunal.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së dytë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse). |

| | |
|---|---|
| | ➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim.<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| MARS | .<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së tretë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Parapërgatitjet për organizimin e shënimit të manifestimt tradicional mbarëkombëtarë “Flakadani I Karadakut”<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i njoftimeve të komunës, përfshirë këtu hartimi i njoftimeve publike në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal për takimin e tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Kuvendit Komunal.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| PRILL | ➢ Përcjellja e aktiviteteve mjedisor në kuadër të shënimit të muajit të pastrimit që kryesisht fillon me 01 prill.<br>➢ Publikimi i njoftimeve të komunës, përfshirë këtu hartimi i njoftimeve publike në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal për takimin e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Kuvendit Komunal.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së katërt të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |

| | |
|---|---|
| MAJ | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 5 majit-Ditës së dëshmorëve në komunën e Vitisë.<br>➢ Publikimi i njoftimeve të komunës, përfshirë këtu hartimi i njoftimeve publike në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal për takimin e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Kuvendit Komunal.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së pestë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| QERSHOR | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 1 qershorit- ditës së fëmijëve.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 14 qershorit-ditës së çlirimit të komunën e Vitisë.<br>➢ Parapërgatitjet për debatin e parë të komunës për periudhën 6 mujore. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Përcjellja e debatit dhe publikimi i informacioneve për publikun.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së gjatë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook.<br>➢ Përgatitjet për raportimet 6 mujore. |
| KORRIK | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 2 korrikut- turnirit në futboll të vogël në Beguncë (sipas statutit të komunës).<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 4 korrikut- Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së shtatë ë të Kuvendit Komunal për publikun. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook.<br>➢ Përgatitjet për raportimet 6 mujore. |
| GUSHT | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të ditës së mërgimtareve<br>➢ Në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, Drejtorinë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe të tjerë organizimi dhe përcjellja e aktiviteteve për hartimin e buxhetit komunal për vitin në vijim.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| SHTATOR | ➢ Publikimi i raportit të konsultimeve publike për hartimin e buxhetit komunal në uebfaqe zyrtare.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së shtatë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| Tetor | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të muajit të ndërgjegjësimit kundër kacerit të gjirit.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së tetë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim.<br>➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| Nëntor | ➢ Përcjellja e aktiviteteve për nder të 28 nëntorit - ditës së Flamurit kombëtar shqiptar<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së nëntë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |
| Dhjetor | ➢ Parapërgatitjet për debatin e II-të të kryetarit për vitin 2022.<br>➢ Përcjellja e debatit dhe publikimi i informacioneve publike.<br>➢ Faza e raportimit të punës së ZIMP-së.<br>➢ Raportimi për periudhën 1 vjeçare në MAPL dhe AIP për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumentet publike.<br>➢ Shënimi i aktiviteteve për nder të fund vitit.<br>➢ Në bashkëpunim me Zyrën e IT-së, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancës së dhjetë të Kuvendit Komunal për publikun.<br>➢ Publikimi i vendimeve të kryetarit.<br>➢ Publikimi i vendimeve të Kuvendit Komunal (nëse është marrë konfirmimi i ligjshmërisë nga organet përkatëse).<br>➢ Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe më pas përcjellja e tij dhe informimi i qytetarëve lidhur me këtë takim ( në rast që mbahet në këtë muaj).<br>➢ Pjesëmarrja në takimin e Këshillit të Drejtorëve dhe informimin publik mbi këtë takim. |

| | |
|---|---|
| | ➢ Përcjellja e aktiviteteve të ndryshme dhe publikimi i informacioneve në ueb faqe zyrtare dhe rrjetin social të komunës në facebook. |

Sqarim: Të bashkangjitur me këtë plan është edhe propozim plani për organizimin e konferencave për media për vitin 2022 të drejtorëve të drejtorive dhe të udhëheqësisë komunale.

**Zyrtarët për Informim Publik**

Agron Abazi

Mustafë Mehmeti